

VENDIM
Nr. 41, datë 13.5.2014

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ENREL HYDRO” SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT
TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-ET “ZEREC 1” DHE “ZEREC 2”**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “a”; 9 dhe 13 pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “a”; 5 pika 1 germa “a”; 13 dhe 14 pika 1 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 13.5.2014, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “EnRel Hydro” sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “EnRel Hydro” sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionit teknik (neni 9, pikat: 4.1.1, 4.1.2, 4.1.4, 4.1.5, 4.1.3), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “EnRel Hydro” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Zerec 1” me fuqi të instaluar 0,55 Mw dhe “Zerec 2” me fuqi të instaluar 1, 315 Mw, me afat 30-vjeçar.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti